

E nderuara drejtuese e seancës!

Unë nuk e di nëse ju do ta përcillni këtë kërkesë timen të karakterit procedural, dhe meqë nuk desha të merrja kohën për procedurë, po e konsumoj tani përpara, pasi prezenca e këtyre kutive të votimit, që sapo u larguan, sigurisht përbën një moment, që përfundimisht e shndërron debatin në këtë parlament në një debat qesharak. Ne flasim, por nuk flasim në kuadrin e një parlamenti, i cili nga debati ka edhe mundësinë teorike të reflektimit, po flasim në një sallë, që ka vendosur, ka mbyllur çdo gjë në kushtet e një paragjykimi të plotë. Duam apo s' duam ne, kjo Rregullore këtu e disiplinon këtë sallë, dhe asnjë rregull tjetër nuk del mbi të. Në qoftë se kjo Rregullore është në fuqi, po ua kërkoj përfundimisht edhe kryetarëve të grupeve parlamentare, që më në fund t'i kthehen kësaj Rregulloreje, sepse u bëmë vërtet qesharakë. Çfarë thotë Rregullorja? Pikërisht neni 74, pika 4 thotë: "Drejtuesi i seancës, pas përfundimit të diskutimit në parim, deklaron kohën kur Kuvendi duhet të vendosë nëpërmjet votimit." Ne po diskutojmë në parim, por ndërkohë kutitë kanë mbaruar, është votuar. A ka ndonjë qytetar që na merr seriozisht ne? Çfarë do të thotë? Përfundimisht, s'ka fare rëndësi se çfarë flisni këtu? Do të thotë se ky debat nënkupton... Ja, i prunë sërish. Shumë interesant është. Situata është më qesharake nga ç'ka qenë. Pra, dua të them se kjo është vërtet një gjë e turpshme. Ne shpresojmë se me debatin të ketë reflektime si nga njëra palë, ashtu edhe nga tjetra. Pra, praktikisht, ky debat është një debat kot, në kuptimin e kësaj sale. Sigurisht, ne u referohemi qytetarëve. Unë shpresoj shumë që ky turp do të marrë fund dhe të mos vazhdojë më në këtë mënyrë, sepse i heq sensin parlamentarizmit.

Por le t'i kthehemi thelbit të gjësë. Praktikisht, besoj se sot jemi në një ndër momentet më të shëmtuara për mënyrën se si është paraqitur ky ligj. E lëmë pjesën e qëllimit të tij, por edhe mënyrën e ndërtimit të tij, besoj se të gjithëve do t'i vinte turp që ne po e diskutojmë. Nuk duhej të ishte fare në sallën e Kuvendit, fare nuk duhej të hynte në këtë sallë. Veçanërisht ata që kanë një profesion tjetër, që kanë edhe profesionin e juristit, do të skuqeshin shumë e shumë më keq. Sepse në një arkitekturë të administratës shtetërore, qartësisht të ndërtuar dhe të rregulluar me ligje, fusin mostra hibride, që s'kanë të bëjnë fare as me një shtet normal, me gjithë problemet që ka ky shteti ynë, por të paktën në lidhje me atë që quhet rregullim formal, e as me një shtet që është i të gjithëve. Këtu kemi të bëjmë vetëm me një ngrehinë të shëmtuar, propagandistike, efekti i së cilës do të ketë as më shumë e as më pak, por motivimin e ca të paguarve të tjerë për të bërë atë vëzhgimin, ato modelet e reja të një spiunllëku bajat, që nuk ndihmon as qytetarët, por tregojnë vetëm fuqinë individuale të militantizmit dhe do të zhvillojnë garën "e shëndetshme" ndërmjet militantëve që janë futur në administratën publike dhe këtyre militantëve të rinj të agjencisë. Efekti është asgjë, por vetëm një turp i ri, që i stabilizohet këtij shteti. Po çfarë ka ky ligj, që në fillimin e tij? Po t'i referoheshim veç një neni të vetëm, ligji nuk duhej të hynte në sallën e parlamentit. Ne kemi një ligj në fuqi, që është ligji "Për organizimin e administratës shtetërore", i cili thotë: "Sipas parimit të llogaridhënies, çdo organ, institucion apo njësi administrative i nënshtrohet drejtimit dhe mbikëqyrjes nga organi epror përkatës, si për veprimtarinë e vet, ashtu edhe për atë të organeve, institucioneve dhe njësive administrative vartëse." Kush është ky, organ epror i kujt është ky? I kujt është ky? Ky është ligji. S'e kemi shfuqizuar

këtë ligj. Ky është ligji i organizimit në Shqipëri. Po mirë tashti, pse çmendet Kryeministri, s'jeton dot pa demagogji, s'jeton dot pa prodhuar propagandë, mos duhet të shkatërrojmë shtetin? Dikush bërtet e thotë: patronazhistët, ata që bënë këtë apo atë. S'bënë gjë fare patronazhistët. Patronazhistët vetëm treguan se ky është një shtet i shpartalluar, i cili synon të kthehet aty ku shteti e partia të jenë një. Kjo ishte një dëshmi përfundimtare. Po përpara se të vini këtu, a e ngritët një agjenci përkatëse, me vendim të Këshillit të Ministrave, që katër vjet të shkuara? Po çfarë do të thotë, meqë s'paska prodhuar asnjë rezultat, që është një nismë e dështuar edhe në nivel qeveritar. Për çfarë vijnë këtu, që po i japin dimensionet e ligjit? Po cilat janë gjithë këta mekanizma që kemi krijuar, një piramidë të miriformuar të shërbimit civil të Republikës, me sistemin e përgjegjësive e të llogaridhënies? Kërkimin e opinionit të qytetarëve? Po është në ligje. Ah, s'e bëni ju? Dakord, por nëse s'e bëni ju, është faj. Nuk e rregullon këtë agjencia, sepse agjencia përbëhet nga të njëjtat bashkëfajtorë, sepse drejtorin e agjencisë e emëron Kryeministri. Edhe një komision, i cili do të shqyrtojë ankimimin për gjokat, edhe atë e ngre Kryeministri. E ku dolëm? Po të ishte për të pyetur qytetarët, unë kam kërkuar dikur, para katër vjetësh, kur ishte çështja e inceneratorit të Fierit, që të bëhej konsultim i detyruar me qytetarët në lidhje me atë incenerator. Nuk e bëtë. E ka ligji. S'i dëgjoni qytetarët. S'doni t'i dëgjoni. Tani do të bëni sikur i dëgjoni nëpërmjet agjencisë së bashkëqeverisjes?! Këto turpe kaq të mëdha mund t'ua kurseni shqiptarëve. Në rast se të gjitha strukturat shtetërore, përfshirë edhe ato të sinjalizimit të brendshëm, se po kjo maxhorancë ka e propozuar ligjin e bilbilfryrësve, qenkan asfiksuar, korrupsioni dhe mosqarja e halleve të qytetarëve paskan vdekur, atëherë, për një qeverisje të vdekur nga qendra e deri poshtë, në pushtetin lokal, për këtë qeverisje reanimacioni, antibiotiku i preferuar, që do të bëjë mrekulli qenka kjo agjenci?! Po mirë atëherë, kam edhe një pyetje tjetër për ata që janë edhe juristë: si mund të miratoni këtë ligj? Nuk keni siklet, nuk ju vjen zor?

Është një ligj që merrni në shqyrtim se cilat do të ishin masat disiplinore që do të merreshin në rastet e kundërvajtjeve: lirim nga detyra, kjo e ajo. Më tutje vjen neni i ankimimeve, dhe në ankimime parashikohet vetëm ankimimi për vendosjen e gjobës. Po për masat e tjera? Apo masat e tjera janë for granted, nuk kanë problem? Për to nuk ka ankimim. Unë e kuptoj që nguti i madh, histeria për të ardhur sa më parë, se s'kemi me çfarë ta mbushim, prandaj le ta mbushim me propagandën e radhës, është ajo që ju bie këtu. E ç'nevojë ka për bashkëqeverisje, që agjencia do të bëka marrëveshje me organet e vetëqeverisjes vendore? Po një nga themelet që ka vetëqeverisja vendore për të gjitha çështjet dhe vendimet e saj, ka marrjen e mendimit të qytetarëve. E ka të shkruar, e ka me ligj. S'e bëjnë 61 kryetarët e bashkive, për të cilët jeni shumë të lumtur që i keni? Po në qoftë se paska një tufë të tillë bataqinjsh, që refuzojnë popullin e tyre, do ta zgjidhë kjo agjenci? Kjo do t'u shtrëngojë rripat? Do të vërë atë koordinatorin aty, që do të thotë, po s'e bëri ky, ky lajmëron Kryeministrin dhe Kryeministri thotë: ta mbaj apo të mos e mbaj, ta kandidoj prapë apo të mos e kandidoj prapë? Po me këto vulgaritete do të na sillni në sallën e parlamentit. Unë mendoj sinqerisht, që sot parlamenti po përjeton një moment të shëmtuar, dhe kushdo që do të donte t'i bënte alibi këtij turpi, ai vetëm e vetëm do të rëndonte pozicionin e tij individual, respektin, sqimën për vete. Në institucione ku kemi bërë po të njëjtat ligje, po kjo maxhorancë i ka bërë, brenda institucioneve ka edhe institucione të kontrollit të brendshëm. Institucione kontrolli të posaçme ka vetë Këshilli i Ministrave. Ka pafundësisht mekanizma kontrolli, por kemi tetë vjet që dëgjojmë platforma pa fund, që kanë kushtuar edhe miliona. Platforma, thoshte dikur ministrja Harito. Platformë tjetër pruri ministri Çuçi. Po meqenëse duhet që çmendurisë së Kryeministrit t'i shkojmë pas, do t'i vëmë edhe emrin e sloganit partiak të Partisë Socialiste: "Për Shqipërinë që duam". Së paku për hipokrizi, këtë lloj turpi mund t'ua kishit kursyer njerëzve. Mirë që është një mostër, një copë gur, një mbeturinë e vendosur në mes të gjithë

strukturës së administrimit të shtetit, po për hipokrizi mund të kishit gjetur një emër tjetër. Me një fjalë shteti, kontrolli, mënyra se si qytetarët do të qeverisin, gjithçka është e lidhur pikërisht me atë psikopatinë e radhës të Kryeministrit, që e do ligj atë që ka pasur agjenci, e që ka qenë plotësisht e falimentuar. (Bie gongu) Sinqerisht, kur u përgatita të flisja, unë kisha idenë të bëjë një ftesë, aq sa mund të hanë shqip ata që s'janë të kapur për fyti nga Kryeministri, për ta ndalur këtë turp të radhës, po përderisa ato kutitë, që sërish u hoqën, se siç duket është kalkuluar që kanë votuar të tërë, tregon se ky diskutim ishte formal dhe se këtë ftesë nuk mund t'ua bëj. Mbajeni për vete këtë turp që po votoni sot!